

OBJEKTIVAT
PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM
NË FUSHËN E MJEDISIT

SYNIMET DHE TREGUESIT
PËR
SHQIPËRINË

192 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara, ndër to edhe Shqipëria në shtator 2015 kanë miratuar Programi 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili është një kornizë globale 15-vjeçare e përqendruar në 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm me 169 synime mbi 230 tregues. Në këtë kuadër qeveria shqiptare është e angazhuar në vijimin e planeve dhe projekteve për t'i bërë realitet Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Axhenda e vitit 2030 synon një botë pa varfëri dhe uri, me arsim cilësor, mbulim shëndetësor universal, arritje të barazisë gjinore dhe fuqizim të grave dhe vajzave, një mjedis të qëndrueshëm duke menaxhuar sistemet e ujësjellës-kanalizimeve, sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë, marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë dhe ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Cilët janë Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) në fushën e mjedisit, synimet dhe indikatorët për Shqipërinë?

OZHQ: 3 Sigurimi e jetesës së shëndetshme, duke promovuar mirëqenien në të gjitha moshat

OBJEKTIVI 3.9

Deri në vitin 2030 të reduktohet numri i vdekjeve dhe sëmundjeve të shkaktuara nga ndotjet që vijnë nga kimikatet, ajri, uji ndotja e tokës.

Kuadri i monitorimit

3.9.1 rastet e vdekjeve si pasojë e ajrit të ndotur në shtëpi dhe mjedis

3.9.2 rastet e vdekjeve si pasojë e ujit të pasigurtë, higjienës jo të sigurtë dhe mungesës së saj (përballja me ujë të pasigurtë, shërbime të higjienës për të gjithë (WASH)

3.9.3 rastet e vdekjeve si pasojë nga hemlimi i paqëllimshëm.

Të gjithë treguesit përsa më sipër nuk monitorohen në Shqipëri.

OZHQ 6: Sigurimi i qasjes dhe menaxhimit të sigurtë i ujit dhe higjienës për të gjithë

Treguesi 6. 1

Deri në 2030 të arrihet qasje e barabartë dhe universale për ujë të një cilësie të mirë dhe të sigurtë për të gjithë.

Kuadri i monitorimit

6.1.1 Përqindja e popullsisë që përdor shërbime të menaxhuara dhe të sigurta të ujit të pijshëm.

Treguesi 6.1.1 monitorohet në Shqipëri. SDSH (Studime Demografike të Shëndetit) mundësojnë informacion të detajuar për përqindjen e popullatës dhe mënyrat e pasjes së ujit të pijshëm.

OBJEKTIVI 6.2

Deri në vitin 2030, të arrihet qasja në kanalizime dhe higjienë të përshtatshme dhe të barabarta për të gjithë dhe t'i jepet fund defekimeve jo sanitare, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe atyre në situata vulnerabël.

Kuadri i monitorimit

6.2.1 Përqindja e popullsisë që përdorin sisteme të menaxhuara dhe të sigurta të higjienës, duke përfshirë larjen e duarve me sapun dhe ujë.

Treguesi 6.2.1 kontrollohet nga SDSH dhe studime të tjera të oganizuara nga INSTAT.

OBJEKTIVI 6.3

Deri në vitin 2030, përmirësimi i cilësisë së ujit duke reduktuar ndotjen, eliminuar hedhjen dhe minimizuar çlirimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajuara dhe rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt globalisht.

Kuadri i monitorimit

6.3.1 Përqindja e ujërave të zeza të trajtuara

6.3.2 Përqindja e institucioneve të ujit me cilësi të mirë.

Treguesi 6.3.1 është pjesërisht i aplikueshëm në Shqipëri. Agjensi Ujësjiellës-Kanalizimeve mundëson të dhëna kombëtare për mbulimin e sistemit të kanalizimeve në vend, i cili nënvizon faktorët themelorë që lidhen me këtë tregues, por nuk pasqyron të njëjtin rezultat.

Treguesi 6.3.2 nuk monitorohet në Shqipëri dhe nuk ka të dhëna.

OBJEKTIVI 6.4

Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm efikasiteti i përdorimit të ujit në të gjithë sektorët dhe të sigurohet tërheqje dhe furnizim i qëndrueshëm me ujë të ëmbël, për të trajtuar mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit.

Kuadri i monitorimit

6.4.1 Ndryshimi në efikasitetin e përdorimit të ujit me kalimin e kohës

6.4.2 Niveli ujqor: tërheqja e ujërave të ëmbla si pjesë e burimeve të disponueshme të ujërave.

Treguesi 6.4.1 është pjesërisht i gjendshëm në Shqipëri. Nuk ka të dhëna për efikasitetin e përdorimit të ujit që përfshin të gjitha rezervat ujore në nivel kombëtar. Informacioni mbi eficientësinë e përdorimit të ujit disponohet vetëm për furnizimin me ujë të qytetarëve, si tregues i performancës së shoqërive të ujësjes në pronësi të pushtetit vendor. Informacioni mbi këtë tregues tregon se 2/3 e ujit të furnizuar nga këto kompani humbet pa krijuar të ardhura.

Treguesi 6.4.2 nuk monitorohet në Shqipëri, nuk ka të dhëna për të.

OBJEKTIVI 6.5

Deri në vitin 2030, zbatimi i menaxhimit të integruar të burimeve ujore në të gjitha nivelet, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar sipas rastit.

Kuadri i monitorimit

6.5.1 Shkalla e zbatimit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore (0-100)

6.5.2 Përqindja e zonës ndërkufitare të basenit me një marrëveshje zbatuese për bashkëpunimin ujorë. Të dy këta tregues nuk maten në Shqipëri.

OBJEKTIVI 6.6

Deri në vitin 2020, të mbrohet dhe rivendosen ekosistemet që lidhen me ujin, duke përfshirë malet, pyjet, ligatinat, lumenjtë, akuiferët dhe liqenet.

Kuadri i monitorimit

6.6.1 Ndryshimi në shtrirjen e ekosistemeve të lidhura me ujin me kalimin e kohës.

Treguesi nuk monitorohet në Shqipëri.

OZHQ 7 Sigurimi i qasjes në energji të përbalueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë

OBJEKTIVI 7.1

Deri në vitin 2030, sigurohet qasje universal në shërbime energjetike të përbalueshme, të besueshme dhe moderne.

Kuadri i monitorimit

7.1.1 Përqindja e popullsisë me akses në energji elektrike.

7.1.2 Përqindja e popullsisë e mbështetur në karburantet dhe teknologjinë e pastër.

Treguesi 7.1.1 nuk është shumë i përshtatshëm për Shqipërinë, pasi vendi ofron akses në energji elektrike për të gjithë popullsinë, nëpërmjet një procesi të përfunduar përpara periudhës së tranzicionit në vitet '90. Rrjeti elektrik zgjerohet dhe përmirësohet vazhdimisht për të përmbushur kërkesën në rritje dhe lidhjet e reja. Treguesi 7.1.2 aktualisht nuk monitorohet në Shqipëri.

OBJEKTIVI 7.2

Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm pjesa e energjisë së rinovueshme në energjinë globale.

Kuadri i monitorimit

7.2.1 Sasia e energjisë së rinovueshme në totalin e konsumit final të energjisë. Treguesi 7.2.1 aplikohet në Shqipëri nëpërmjet informacionit të dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

OBJEKTIVI 7.3

Deri në vitin 2030, dyfishi i shkallës globale të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

7.3.1 Intensiteti i energjisë i matur në terma të energjisë fillestare dhe PBB-së. Informacioni parësor për këtë tregues arrihet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, por llogaritja e tij duhet të përdoret si referencë për PBB-në.

OZHQ 8 Promovimi i rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit dhe punës së denjë për të gjithë

OBJEKTIVI 8.2

Arritja e niveleve më të larta të produktivitetit ekonomik përmes diversifikimit, përmirësimit teknologjik dhe inovacionit, duke u fokusuar në sektorët me vlerë të lartë të shtuar dhe me intensitet të punës.

Kuadri i monitorimit

8.2.1 Norma vjetore e rritjes së PBB-së reale për çdo person të punësuar.

Ky tregues nuk monitorohet në Shqipëri

OBJEKTIVI 8.4

Përmirësimi në mënyrë progresive, deri në vitin 2030, efikasitetet global të burimeve në konsum dhe prodhim, shkëputur rritjen ekonomike nga degradimi i mjedisit, në

përputhje me Kornizën 10-vjeçare të Programeve për Konsumin dhe Prodhimin e Qëndrueshëm dhe vendet e zhvilluara që marrin drejtimin.

Kuadri i monitorimit

8.4.1 Gjurma materiale për frymë dhe gjurma materiale për PBB

8.4.2 Konsumi i brendshëm i materialit, konsumi i brendshëm i materialit për frymë dhe konsumi i brendshëm i materialit për PBB

Treguesit 8.4.1 dhe 8.4.2 nuk monitorohen në Shqipëri.

OBJEKTIVI 8.9

Deri në vitin 2030, hartohen dhe zbatohen politika për të promovuar turizmin e qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet vendase.

Kuadri i monitorimit

8.9.1 PBB-ja direkt nga turizmi në raport me PBB-në totale dhe në normën e rritjes.

8.9.2 Përqindja e vendeve të punës në industrinë e turizmit të qëndrueshëm ndaj totalit të vendeve të punës në turizëm.

Sipas informacionit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Turizmit, vlera e treguesit 8.9.1 për vitin 2015 ishte 6% dhe objektivi për vitin 2020 6.5%. Treguesi 8.9.2 nuk aplikohet në Shqipëri.

OZHQ 11 Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme

OBJEKTIVI 11.5

Deri në vitin 2030, reduktimi i ndjeshëm i numrit të vdekjeve dhe numrin e njerëzve të prekur, duke ulur ndjeshëm humbjet e drejtpërdrejta ekonomike në raport me produktin e brendshëm bruto global të shkaktuar nga fatkeqësitë, përfshirë edhe ato të lidhura me ujin, me fokus mbrojtjen e të varfërve dhe njerëzve në situata të cenueshme (vulnerabël).

Kuadri i monitorimit

11.5.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë për 100,000 banorë.

11.5.2 Humbje e drejtpërdrejta ekonomike në raport me PBB-në globale, dëmtime në infrastrukturën kritike dhe ndërprerje në shërbimet bazë, që i atribuohen fatkeqësive.

Informacioni për treguesin 11.5.1 dhe 11.5. 2 është mbledhur nga Departamenti i Emergjencave Civile, Ministria e Brendshme

OBJEKTIVI 11.6

Deri në vitin 2030, zvogëlohet ndikimin i pafavorshëm mjedisor për frymë të qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit dhe menaxhimit të mbetjeve komunale dhe mbetjeve të tjera.

Kuadri i monitorimit

11.6.1 Përqindja e mbetjeve të ngurta urbane të grumbulluara rregullisht dhe me shkarkim përfundimtar adekuat nga totali i mbetjeve të ngurta urbane të krijuara, sipas qyteteve

11.6.2 Nivelet mesatare vjetore të grimcave të imta (PM2.5 dhe PM10) në qytete.

Treguesi 11.6.1 është pjesërisht i aplikueshëm në Shqipëri. Ministria e Mjedisit dhe Turizmit jep informacionin për qytetet kyçe, por jo sipas standardit të kërkuar nga metodologjia e këtij treguesi.

Treguesi 11.6.2 disponohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me të dhëna për qytetet kryesore të vendit.

OBJEKTIVI 11.7

Deri në vitin 2030, të sigurohet akses universal në hapësira të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Kuadri i monitorimit

11.7.1 Pjesa mesatare e sipërfaqes së ndërtuar të qyteteve që është hapësirë e hapur për përdorim publik për të gjithë, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara

11.7.2 Përqindja e personave viktime të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt pasardhës.

Indikatori 11.7.1 nuk monitorohet në Shqipëri.

Treguesi 11.7.2 është pjesërisht i monitorueshëm nga Ministria e Brendshme, pasi nuk janë të disponueshme të gjitha dimensionet e kërkuara nga përkufizimi i treguesit.

OZHQ 12 Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

OBJEKTIVI 12.1

Zbatimi i Kornizës 10-vjeçare të programeve për modelet e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm, duke ndërmarrë veprime nga të gjitha vendet si edhe vendet e zhvilluara që marrin drejtimin, duke marrë parasysh zhvillimin dhe aftësitë e vendeve në zhvillim.

Kuadri i monitorimit

12.1.1 Numri i vendeve me plane kombëtare të veprimit për konsum dhe prodhim të qëndrueshëm, të integruara si prioritet ose objektivi në politikat kombëtare. Në Shqipëri nuk disponohet asnjë informacion në lidhje me këtë tregues.

OBJEKTIVI 12.2

Deri në vitin 2030, të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi efikas i burimeve natyrore.

Kuadri i monitorimit

12.2.1 Gjurma materiale për frymë dhe gjurma materiale për PBB.

12.2.2 Konsumi i brendshëm i materialit për frymë dhe konsumi i brendshëm i materialit për PBB.

OBJEKTIVI 12.4

Deri në vitin 2020, të arrihet një menaxhim i mirë mjedisor i kimikateve dhe të gjitha mbetjeve gjatë ciklit të tyre jetësor, në përputhje me kornizat ndërkombëtare të dakordësuara dhe të zvogëlohet ndjeshëm çlirimi i tyre në ajër, ujë dhe tokë, në mënyrë që të minimizohen ndikimet e tyre negative në shëndetin e njeriut dhe mjedis.

Kuadri i monitorimit

12.4.1 Numri i palëve në marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore shumëpalëshe për mbetjet e rrezikshme dhe kimikatet e tjera që përmbushin angazhimet dhe detyrimet e tyre në transmetimin e informacionit siç kërkohet nga çdo marrëveshje përkatëse.

12.4.2 Mbetjet e rrezikshme të krijuara për frymë dhe përqindja e mbetjeve të rrezikshme të trajtuara, sipas llojit të trajtimit.

Për Shqipërinë nuk ka informacion për asnjë nga indikatorët e mësipërm.

OBJEKTIVI 12.5

Deri në vitin 2030, reduktim të ndjeshëm në gjenerimin e mbetjeve përmes parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.

Kuadri i monitorimit

12.5.1 Norma kombëtare e riciklimit, ton material të ricikluar.
Për këtë indikator nuk ka informacion për Shqipërinë

OBJEKTIVI 12.8

Deri në vitin 2030 njerëzit kudo të kenë informacionin dhe ndërgjegjësimin përkatës për zhvillim të qëndrueshëm dhe stile jetese në harmoni me natyrën.

Kuadri i monitorimit

12.8.1 Përfshirje në (i) edukimi për qytetarinë globale dhe (ii) edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (përfshirë edukimin për ndryshimet klimatike) përfshirje në (a) politikat kombëtare të arsimit; (b) kurrikula; (c) edukimi i mësuesve; dhe (d) vlerësimi i nxënësve.

OZHQ 13 Marrja urgjente e masa për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e saj.

OBJEKTIVI 13.1

Të forcohet elasticiteti dhe kapaciteti adaptues ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësive natyrore në të gjitha vendet.

Kuadri i monitorimit

13.1.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë për 100,000 banorë

13.1.2 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë strategji kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me Kuadrin Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030

13.1.3 Përqindja e qeverive vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë lokale të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me strategjitë kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Informacioni për treguesin 13.1.1 është mbledhur nga Departamenti i Emergjencave Civile, Ministria e Brendshme.

Treguesi 13.1.3 mund të jetë i dobishëm për të nxitur qeveritë vendore në miratimin e strategjive për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë.

OBJEKTIVI 13.2

Integrimi i masave të ndryshimit të klimës në politikat, strategjitë dhe planifikimin kombëtar.

Kuadri i monitorimit

13.2.1 Numri i vendeve që kanë komunikuar krijimin ose funksionalizimin e një politike / strategjie / plani të integruar që rrit aftësinë e tyre për t'u përshtatur me ndikimet negative të ndryshimeve klimatike dhe për të nxitur

qëndrueshmërinë klimatike dhe zhvillimin e emetimeve të ulëta të gazeve serë në një mënyrë që nuk kërcënojnë prodhimin e ushqimit (përfshirë një plan kombëtar përshtatjeje, kontribut të përcaktuar në nivel kombëtar, komunikim kombëtar, raport përditësues dyvjeçar ose të tjera).

Treguesi 13.2.1 aktualisht nuk monitorohet në Shqipëri.

OBJEKTIVI 13.3 Përmirësimi i edukimit, ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen, reduktimin e ndikimit dhe paralajmërimin e hershëm.

Kuadri i monitorimit

13.3.1 Numri i vendeve që kanë integruar zbutjen, përshtatjen, reduktimin e ndikimit dhe paralajmërimin e hershëm në kurrikulat fillore, të mesme dhe terciare

13.3.2 Numri i vendeve që kanë komunikuar për forcimin e ngritjes së kapaciteteve institucionale, sistematike dhe individuale për të zbatuar veprimet e adaptimit, zbutjes dhe transferimit të teknologjisë dhe zhvillimit.

Treguesi 13.3.1 është i përfshirë gjerësisht dhe ofron hapësirë të mjaftueshme për gjykim subjektiv.

Treguesi 13.3.2 nuk është një tregues që mund të monitorohet rregullisht, por Shqipëria nuk i plotëson kërkesat e saj për t'u konsideruar i përfunduar.

OZHQ 14 Ruajtja dhe përdormi në mënyrë të qëndrueshme e oqeanëve, detet dhe burimet detare për zhvillim të qëndrueshëm

OBJEKTIVI 14.1

Deri në vitin 2025, parandalimi dhe reduktimi i ndjeshëm i ndotjes detare të të gjitha llojeve, veçanërisht nga aktivitetet në tokë, duke përfshirë mbeturinat detare dhe ndotjen me lëndë ushqyese.

Kuadri i monitorimit

14.1.1 Indeksi i eutrofikimit bregdetar dhe densitetit të mbetjeve plastike lundruese. Informacioni për këtë tregues nuk disponohet në Shqipëri

OBJEKTIVI 14.2

Deri në vitin 2020, menaxhimi dhe mbrojtja në mënyrë të qëndrueshme të ekosistemeve detare dhe bregdetare për të shmangur ndikimet negative të rëndësishme, duke përfshirë forcimin e qëndrueshmërisë së tyre, ndërmarrja e veprime për restaurimin e tyre në mënyrë që të arrihen oqeanë të shëndetshëm dhe produktiv.

OBJEKTIVI 14.3

Minimizimi dhe adresimi i ndikimeve të acidifikimit të oqeanit, duke përfshirë bashkëpunimin e zgjeruar shkencor në të gjitha nivelet.

Kuadri i monitorimit

14.3.1 Aciditeti mesatar detar (pH) i matur nga grupi i dakortësuar i stacioneve përfaqësuese të kampionimit.

Informacioni mbi treguesin 14.3.1 nuk disponohet në Shqipëri.

OBJEKTIVI 14.4

Deri në vitin 2020, rregullohet në mënyrë efektive peshkimi dhe ndalohet mbipeshkimi, peshkimin e paligjshëm, të pa raportuar dhe të pa rregulluar dhe praktikatat shkatërruese të peshkimit, duke zbatuar plane menaxhimi të bazuara në shkencë, në mënyrë që të rivendosen rezervat e peshkut në kohën më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivele që mund të prodhojnë rendiment maksimal të qëndrueshëm siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike.

Kuadri i monitorimit

14.4.1 Përqindja e rezervave të peshkut brenda niveleve biologjikisht të qëndrueshme

Treguesi 14.5 Deri në vitin 2020, ruajtja e të paktën 10 për qind të zonave bregdetare dhe detare, në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe bazuar në informacionin më të mirë shkencor të disponueshëm.

14.5.1 Mbulimi i zonave të mbrojtura në raport me zonat detare.

Informacioni për treguesin 14.5.1 disponohet nga Ministria e Mjedisit.

OBJEKTIVI 14.6

Deri në vitin 2020, të ndalohen forma të caktuara të subvencioneve të peshkimit që kontribuojnë në mbikapacitetin dhe mbipeshkimin, të eliminohen subvencionet që kontribuojnë në peshkimin ilegal, të paraportuar dhe të parregulluar dhe të përmbahen nga futja e subvencioneve të reja të tilla, duke njohur trajtimin e duhur dhe efektiv të veçantë dhe të diferencuar për vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara, duke qenë një pjesë integrale e negociatave të Organizatës Botërore të Tregtisë për subvencionet e peshkimit.

Kuadri i monitorimit

14.6.1 Progresi i vendeve në shkallën e zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare që synojnë të luftojnë peshkimin ilegal, të paraportuar dhe të parregulluar. Treguesi 14.6.1 është i përcaktuar gjerësisht dhe nuk disponohet në Shqipëri.

Qëllimi 15 Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhoni i qëndrueshëm i pyjet, lufta kundrejt shkretëtirëzimit dhe degradimin e tokës, humbjes së biodiversitetit

OBJEKTIVI 15.1 Deri në vitin 2020, të sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve të ujërave të ëmbla tokësor dhe të brendshëm dhe shërbimeve të tyre, në veçanti pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata, në përputhje me detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.

Kuadri i monitorimit

15.1.1 Sipërfaqja pyjore në raport me sipërfaqen totale të tokës

15.1.2 Përqindja e zonave të rëndësishme për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla që mbulohen nga zonat e mbrojtura, sipas llojit të ekosistemit. Të dhënat për treguesin 15.1.1 disponohen nga Ministria e Mjedisit dhe INSTAT.

OBJEKTIVI 15.2 Deri në vitin 2020, promovohet dhe zbatohet menaxhimi i qëndrueshëm i të gjitha llojeve të pyjeve, duke ndaluar shpyllëzimin, rivitalizuar pyjet e degraduara dhe rritur ndjeshëm pyllëzimin dhe ripyllëzimin në nivel global.

Kuadri i monitorimit

15.2.1 Progresi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve

OBJEKTIVI 15.3

Deri në vitin 2030, të luftohet shkretëtirëzimi, rikthehet toka e degraduar, duke përfshirë tokën e prekur nga shkretëtirëzimi, thatësira dhe përmytjet, duke arritur neutralitetin ndaj degradimit të tokës.

Kuadri i monitorimit

15.3.1 Përqindja e tokës së degraduar mbi sipërfaqen totale të tokës

OBJEKTIVI 15.4

Deri në vitin 2030, të sigurohet ruajtja e ekosistemeve malore, duke përfshirë biodiversitetin e tyre, në mënyrë që të rritet kapaciteti i tyre për të ofruar përfitime që janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm.

Kuadri i monitorimit

15.4.1 Mbulimi nga zonat e mbrojtura të zonave të rëndësishme për biodiversitetin malor.

15.4.2 Indeksi i Mbulesës së Gjelbër malore.

Treguesi 15.4.1 është pjesërisht i disponueshëm (zona të mbrojtura) në Shqipëri nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencitë e saj.

Treguesi 15.4.2 nuk monitorohet në Shqipëri.

OBJEKTIVI 15.5 Të ndërmerren veprime urgjente dhe domethënëse për të reduktuar degradimin e habitateve natyrore, për të ndaluar humbjen e biodiversitetit dhe, deri në vitin 2020, për të mbrojtur dhe parandaluar zhdukjen e specieve të kërcënuara.

Kuadri i monitorimit

15.5.1 Indeksi i Listës së Kuqe. Lista e Kuqe është miratuar në Shqipëri me urdhrin nr.1280, datë 20.11.2013.

OBJEKTIVI 15.6

Promovimi i ndarjes së drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i burimeve gjenetike dhe promovimi i aksesit të duhur në burime të tilla, siç është rënë dakord ndërkombëtarisht.

Kuadri i monitorimit

15.6.1 Numri i vendeve që kanë miratuar korniza legjislative, administrative dhe politikash për të siguruar ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve. Treguesi 15.6.1 nuk është i disponueshëm në Shqipëri.

OBJEKTI 15.9

Deri në vitin 2020, të integrohen vlerat e ekosistemit dhe biodiversitetit në planifikimin kombëtar dhe lokal, proceset e zhvillimit, strategjitë dhe llogaritë e reduktimit të varfërisë.

Kuadri i monitorimit

15.9.1 Progresi drejt objektivave kombëtare të vendosura në përputhje me objektivin 2 të Biodiversitetit Aichi të Planit Strategjik për Biodiversitetin 2011-2020. Siç u përmend më lart, ky tregues monitorohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.